

**SBASHK****Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kultures**

Arsimimi

KULTURA E NJERIUT*Ë-buletin**Janar, 2021*

Dy takime të rëndësishme në Kryeministri Kryeministri Hoti e Ministri Likaj reflektojnë pozitivisht



E mërkura e 20 janarit ka shënuar kthesë pozitive në dialogun në mes të SBASHK-ut dhe Qeverisë Hoti. Ky takim i ka paraprirë takimit të së premtes në të cilin kanë marrë pjesë edhe ministri Ramë Likaj dhe zv/Ministri Xhavit Rexhaj. Kryeministri në detyrë Avdullah Hoti ka pritur në një takim pune kryetarin e SBASHK-ut Rahman Jasharaj dhe ... (faqe 4)

Një aktivitet me arritje të larta e që po vazhdon edhe në vitin 2021

Kërkesa të shumta për trajnimet e licencuara të SBASHK-ut

Krahas shumë angazhimeve në vitin 2020, SBASHK-u ka shënuar arritje të larta edhe në organizimin... (faqe 8)


Intervistë me kryetarin e SBASHK-ut, Rahman Jasharaj

Sfidat e janarit i kaluam me sukses, vazhdojmë me angazhimet




Është fillimi i vitit 2021. Janari për SBASHK-un solli sfida të reja ... (faqe 3)

Komunikim i vazhdueshëm me ETUCE Mbështetje e fuqishme për SBASHK-un



SBASHK-u, si edhe gjithë sindikatat e ... (faqe 7)

Mbledhja e jashtëzakonshme e Këshillit Drejtues Debat i hapur dhe vendim unanim



Sa vinte e afrohej 18 janari, kur ishte paraparë të niste periudha ... (faqe 5)



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës
The Union of Education, Science and Culture

Editorial

Angazhime, sfida, takime të shumta



Janari e gjeti arsimin e Kosovës në përgatitje për të nisur me periudhën e dytë të mësimin, por edhe me sfida e çështje që kërkonin zgjidhje. Dy ishin kërkesat e anëtarësisë që u bënë publike dhe u prezantuan edhe në takimet me ministrin Likaj e kabinetin e tij e pastaj edhe në takimet me Kryeministrin Hoti. Këshilli Drejtues në takimin e jashtëzakonshëm bashkë me kryetarët e nivelit komunal sindikal dhe të Universiteteve autorizoi kryetarin dhe Kryesinë që të vazhdojnë edhe për ca ditë në përpjekjet që me dialog të gjejnë zgjidhje për këto kërkesa, duke e lënë të hapur

opsionin për veprime sindikale. Takimet me institucionet vazhduan dhe në takimin me Kryeministrin Hoti, me ministrin Likaj e zv/ministrin Rexhaj të premten e 22 janarit ku u arrit marrëveshje për një shtesë në pagat e të punësuarve në arsimin e Kosovës dhe për nënshkrimin e Kontratës së re Kolektive për Arsimin e Kosovës.

Pajtueshmëria mes palëve pas takimit në kabinetin e Kryeministrit Hoti u bë publike para medieve me të kryer të këtij takimi. Po këtë ditë në kabinetin e Ministrit Likaj u nënshkrua Kontrata e re Kolektive e Arsimit të Kosovës.

Vlen të kujtojmë se çështjet e përcaktuara brenda Kontratës vlejnë vetëm për të punësuarit në sektorin e arsimit që janë anëtarë të SBASHK-ut.

Për çdo pyetje, sugjerim apo informata shtesë, mund të vizitoni ueb-faqen tonë:

www.sbashk-rks.org

Mos hezitoni të na jepni sugjerime për përfshirjen edhe të ndonji rubrike në interes të anëtarësisë në gazeten e juaj elektronike Arsimi sot.

Që SBASHK-u të jetë gjithnjë në shërbim të anëtarësisë, së shpejti do të ofroj shërbime këshillimi për ngritje profesionale për anëtarët e vet si dhe së shpejti do të paraqiten video-spote në ueb-faqen e SBASHK-ut rreth shërbimeve për anëtarësinë.

Botues: Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK)

përfaqëson rreth 20.500 anëtarë në gjithë sektorët e arsimit në Kosovë, duke përfshirë edhe komunitetet. SBASHK është anëtare e **Edukimit Internacional (EI)** që nga viti 1996.

Email: info@sbashk-rks.org

Tel. +383 (0) 38 226 940



Intervista

Intervistë me Kryetarin e SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj

Sfidat e janarit i kaluam me sukses, vazhdojmë me angazhimet



Është fillimi i vitit 2021. Janari për SBASHK-un solli sfida të reja. Falë përkushtimit e unitetit dhe reflektimit të institucioneve u arrit të ketë marrëveshje për dy kërkesat e anëtarësisë. Tani në një situatë më të qetë po punohet për të bërë një plan të veprimit dhe për të vazhduar me angazhimet. Për këto na flet kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj.

Arsimimi sot:

Si nisi viti 2021 për SBASHK-un ?

Jasharaj:

Mendonim se viti 2020 ishte nga më të vështirit për ne dhe për arsimin në Kosovë në tërësi. Ne e analizuam në organet gjegjëse të sindikatës sonë atë vit dhe vlerësuam se edhe përkundër gjithë atyre vështirësive të krijuara edhe nga pandemia, kemi arritur të shënojmë rezultate të larta në shumë angazhime e aktivitete në shërbim të anëtarësisë. E kritikua vitin 2020 si mjaft të vështirë, por duket se as ky viti që e filluam para ca ditësh nuk do të jetë i lehtë. Këtë e tregoi janari që na doli me shumë sfida e angazhime. Na doli edhe me situatën ose dialog e marrëveshje ose të niset me verime sindikale. Uniteti e përkushtimi , por edhe reflektimi i institucioneve bëri që të rrimë zgjidhje të pranuar për të dy kërkesat e anëtarësisë. Për këtë shpreh respekt të lartë e meritë për koordinatoren për organizim të brendshëm Ymer Ymeri, por edhe për stafin e kryesinë, që u munduan

të kontribuojnë për të arritur realizimin e kërkesave legjitime .

Arsimimi sot:

Ishte situata dialog e marrëveshje, ose veprime sindikale ?

Jasharaj:

Po ashtu ishte. SBASHK vlerëson larg dhe i jep gjithmonë hapësirë dialogut e marrëveshjeve , por është i njohur edhe për veprime sindikale . Kështu ishte edhe në këtë janar, por u bë mirë që palët reflektuan dhe kishim dy takime se fundmi me Kryeministrin Hoti dhe me Ministrin Likaj dhe erdhi deri të marrëveshja.

Arsimimi sot:

Tani jeni më të relaksuar, çfarë tutje?

Jasharaj:

Koordinatori për organizim të brendshëm bashkë me stafin mbajnë takime në mëngjes të çdo dite dhe shohin nga afër se cilat janë obligimet dhe detyrat konkrete për atë ditë, por duke analizuar gjendjen dhe duke caktuar edhe detyra për tërë javën. Po ashtu i dimë edhe çështjet dhe aktivitetet kyçe për tërë vitin që kanë të bëjnë me angazhimet në nivel vendi dhe në bashkëpunimin e komunikimin me sindikatat simotra dhe me Unionin e Sindikatave të Arsimit të Evropës dhe me Internacionalen Botërore të Arsimit.

Një pjesë të angazhimeve tona do ia kushtojmë edhe trajnimeve sepse kjo është kërkesë e anëtarësisë sonë kudo në Kosovë dhe shërben edhe për përgatitjen e vazhdueshme të personelit arsimor dhe për ngritjen e cilësisë në arsim. Do të vazhdojmë të jemi aktiv edhe në takimet e grupet punuese , në të cilat debatohet e sjellën vendime për çështjet arsimore duke dhënë kontributin tonë konkret.

Arsimimi sot:

Veçoni edhe ndonjë çështje që do ta aktualizoni serish

Jasharaj:

Do të angazhohemi bashkë me MASH për të gjetur zgjidhje përfundimtare për kolegët tanë që janë në sistemin arsimor e që kanë 180 kredi, pastaj do të angazhohemi po ashtu me MASH për zgjidhjen e drejtë e përfundimtare të çështjes së kolegëve anë me

sëmundje të rënda dhe besoj do ta kemi një angazhim madh e konkrete edhe lidhur me çështjen e Ligjit të pagave, i cili tani më do të duhej të ishte në funksion duke zgjidhur humb çështje një herë e mirë, por ja që te ne ndodhin gjëra e gjëra dhe duhet bërë edhe beteja të reja sindikale për këtë Ligj. Do të organizojmë edhe aktivitete të tjera duke u bazuar në kërkesat e kohës dhe në kërkesat dhe zërin e anëtarësisë sonë.

Gjatë muajit

Dy takime të rëndësishme në Kryeministri

Kryeministri Hoti e Ministri Likaj reflektojnë pozitivisht

E mërkura e 20 janarit ka shënuar kthesë pozitive në dialogun në mes të SBASHK-ut dhe Qeverisë Hoti. Ky takim i ka paraprirë takimit të së premtes në të cilin kanë marrë pjesë edhe ministri Ramë Likaj dhe zv/Ministri Xhavit Rexhaj. Kryeministri në detyrë Avdullah Hoti ka pritur në një takim pune kryetarin e SBASHK-ut Rrahman Jasharaj dhe koordinatorin për organizim të brendshëm, Ymer Ymeri.



Përfaqësuesit e SBASHK-ut kanë informuar Kryeministrin Hoti për gjendjen aktuale në arsim dhe për dy kërkesat e bëra publike të anëtarësisë duke kërkuar nga Kryeministri që të gjej mundësi buxhetore për një shtesë në pagë për të gjithë të punësuarit në sektorin e arsimit për arsye të shtimit të volumit të punës dhe të rrezikut të lartë nga prekja me Covid-19. Po ashtu me Kryeministrin është biseduar edhe për angazhimet e bëra dhe për pajtueshmërinë e plotë të Komisionit të përbashkët MASH- SBASHK lidhur me Kontratën e re Kolektive të Arsimit dhe delegacioni i SBASHK-ut është shprehur i bindur se Kontrata do të

nënshkruhet nga Ministri Likaj për të cilin kanë deklaruar se gjithmonë ka qenë shembull i mirë i bashkëpunimit dhe angazhimit të përbashkët në shërbim të arsimit. Pas takimit Kryeministri Hoti ka dalë me një komunikatë në të cilën thuhej: “Kryeministri Hoti, fillimisht e ka përgëzuar kryetarin e SBASHK-ut Rrahman Jasharaj, për punën e palodhshme dhe sfiduese të arsimtarëve në kushte të pandemisë, si dhe e ka siguruar që pagesa shtesë për punëtorët e arsimit do të kryhet në dy këste. Këstin e parë do ta marrin me pagën e muajit shkurt, ndërsa këstin e dytë me pagën e muajit maj. Për shumën e pagës shtesë, Ministria e Arsimit, SBASHK-u dhe Ministria e Financave do të dakordohen në përputhje me mundësitë buxhetore. Në takim me përfaqësuesit e SBASHK-ut, Kryeministri në detyrë Hoti, ka biseduar edhe për Kontratën e re Kolektive, e cila pritet të finalizohet këtë të premte”, është thënë në këtë komunikatë, për të shtuar se takimi i radhës do të mbahet të premten e 22 janarit.



Në takimin e së premtes u bisedua edhe një herë për dy kërkesat e SBASHK-ut dhe marrëveshjet e arritura u deklaruan para medieve nga Kryeministri Hoti, Ministri Likaj dhe kryetari Jasharaj. Po të premten e 22 janarit në ambientet e MASH u nënshkrua Kontrata e re Kolektive e Arsimit nga Ministri i MASH, Ramë Likaj dhe kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj.




Mbledhja e jashtëzakonshme e Këshillit Drejtues **Debat i hapur dhe vendim unanim**

Sa vinte e afrohej 18 janari, kur ishte paraparë të niste perioda e dytë e procesit mësimor në institucionet e Arsimit, po shtoheshin edhe pikëpyetjet se a do të ndodhte kjo ngase ishin dy kërkesa të bëra publike nga SBASHK e në emër të anëtarësisë e që ende nuk kishin gjetur zgjidhje nga institucionet e vendit tonë. Të gjendur në këtë situatë e me qëllim që të bashkëbisedohej shtruar e të merreshin vendime unanime për veprime varësisht nga situata e krijuar. U mbajt mbledhje e jashtëzakonshme e Këshillit Drejtues . Në këtë takim merrnin pjesë edhe kryeartët e Kuvendeve komunale të Arsimit parauniversitar dhe i Universiteteve për të kontribuar në rrjedhën e mbarë të takimit të jashtëzakonshëm, pasi ata kishin pasur një takim paraprak konsultativ dhe kishin analizuar mirë e qetë situatën dhe kishin dhënë edhe ide konkrete se çfarë mund të veprohej në të ardhmen.



Në këtë takim të jashtëzakonshëm pjesëmarrësit e analizuar edhe një herë situatën aktuale në arsim duke u ndalur veçmas te kërkesat e anëtarësisë kërkesat e anëtarësisë lidhur me shtesën në paga për arsye të punës në kushteve të vështirësuar nga pandemia dhe rreziku nga prekja me Covid-19 dhe për Kontratën e re Kolektive të Arsimit.



Pas një debati të hapur duke vlerësuar edhe situatën aktuale në Kosovë dhe duke analizuar me kujdes këto dy kërkesa të anëtarësisë , pjesëmarrësit e këtij takimi të jashtëzakonshëm kishin sjellë përfundimin perioda e dytë e mësimit të nis më 18 janar, por që greva të mbetet option i hapur. Do theksuar se kishte nga pjesëmarrësit që duke prezantuar qëndrimet e bazës së tyre po kërkonin që të nisët me veprime sindikale që më 18 janar, pasi, si thana ata , i është dhënë mjaft kohë dialogut. Mirëpo shumica e pjesëmarrësve ishin që më 18 janar të nis perioda e dytë e mësimit dhe autorizuan Kryesinë dhe kryetarin e SBASHK-ut që të vazhdojnë me përpjekjet që këto dy çështje t'i zgjedhin me dialog përmes takimeve me krerët e institucioneve, por e kanë lënë të hapur edhe optionin e veprimeve sindikale dhe kanë vendosur që në ndërkohë të shpërndareshin formularë të e gjithë anëtarësia përmes të cilëve do të dëshmohej, edhe një herë, mbështetja e fuqishme për vendimin e Këshillit Drejtues.

SBASHK realizon kërkesën e kolegëve nga Lipjani , Malisheva e Mitrovica

Rinis edhe trajnimi "Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie"

Duke e parë se kolegëve tanë kudo në Kosovë institucionet po ju kërkojnë numër të konsideruar të orëve të trajnimeve për të marrë licencën e punës e për të krijuar parakushte edhe për gradimet dhe duke vërejtur se të tjerët nuk po bëjnë as afërsisht sa duhet në këtë aspekt, SBASHK-u shtoi në vargun e angazhimeve të veta edhe një aktivitet tepër të rëndësishëm, por që kërkon angazhime maksimale të tërë stafit qendror dhe të kryetarëve të nivelit komunal sindikal. Ka vite që u organizuan me kujdes të pesë trajnimet e licencuara, që u mundësonin kolegëve tanë të merrnin njohuri të reja dhe të kishin dëshmi për kryerjen e trajnimeve të caktuara. Duke respektuar vullnetin e kolegëve tanë ky aktivitet nuk u ndërpre as në rrethanat e kushtet e vështirësuar nga Covid 19. Trajnimet "Forcimi i kapaciteteve për udhëheqjen efektive të dialogut social" "Udhëheqja dhe planifikimi strategjik në Arsimin Parauniversitar", "Edukimi medial dhe roli i tij në zhvillimin shoqëror dhe demokratik", "Mësimdhënia e gjuhës dhe letërsisë shqipe për ciklin fillor dhe të mesëm" u mbajtën nga larg përmes platformës gjegjëse dhe janë shënuar e po shënohen arritje e rezultate për çdo lëvdatë.



Mirëpo për një kohë rrethanat e krijuara nga pandemia kishin bërë që të mos organizohej trajnimi "Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie" ngase ai kërkon kushte të veçanta dhe duhet zhvilluar në institucione arsimore e me pajisje të nevojshme. Këto kërkesa u realizuan me të filluar të procesit arsimor në institucionet arsimore dhe koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri bashkë me stafin qendror e

me kryetarë të nivelit komunal sindikal kanë rinisur me organizimin e këtij trajnimi.



U fillua me kolegët nga komuna e Lipjanit dhe Malishevës për të vazhduar pastaj edhe me një grup kolegësh nga Mitrovica. Teksa kolegët tanë nga këto tri komuna po mbanin trajnimin "Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie" në ambientet shkollore me t kanë bashkëbiseduar për disa qaste nga larg kryetari i SBASHK, Rrahman Jasharaj dhe koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri.



Kryetari Jasharaj ka përgëzuar për angazhimet koordinatorin Ymeri, stafin qendror, kryetarët Emrush


Ahmerti, Skënder Gashi e Isa Ismajli dhe trajnerët Idriz Sopa, Albert Samadraxha dhe Fevzi Selmani.



Koordinatori Ymer Ymeri ka bashkëbiseduar nga larg me pjesëmarrësit e trajnerët duke ua kujtuar se ky është trajnim që kërkon kushte të veçanta dhe se në këto tri komuna po shihet se ato janë krijuar.

Komunikim i vazhdueshëm me ETUCE **Mbështetje e fuqishme për SBASHK-un**

SBASHK-u, si edhe gjithë sindikatat e arsimit nga shtetet e Evropës, kanë qenë në komunikim të vazhdueshëm me stafin qendror në Bruksel duke përcjellë informacione për gjendjen aktuale të krijuar nga Covid-19 dhe për gjithë sfidat dhe angazhimet. SBASHK-u informoi me kohë drejtoreshën e përgjithshme të ETUCE-s, znj. Suzan Flocken për angazhimet e bëra, për situatën aktuale, për dy kërkesat e bëra publike të anëtarësisë dhe për opsionin e hapur të veprimeve sindikale sipas vendimit të Këshillit Drejtues.



Duke dëshmuar se shqetësimet e ngritura nga SBASHK-u janë kuptuar, si gjithmonë, shumë seriozisht, drejtorja e përgjithshme, Suzan Flocken, ka mbajtur një takim nga larg me përfaqësuesit e SBASHK-ut dhe ka marrë informacione shtesë për aktualitetin në arsimin e Kosovës dhe për angazhimet e preokupimet e sindikatës sonë. Ajo ka lavdëruar SBASHK-un për përkushtimin në shërbim të anëtarësisë, por edhe për përpjekjet e vazhdueshme



Ai ka treguar se pas çdo moduli pjesëmarrësit do të dëshmojnë arritjet përmes testit të njohurive, të cilin pjesëmarrësit do ta plotësojnë po ashtu duke qenë në ambient shkollorë dhe do të certifikohen vetëm ata që arrijnë numrin e duhur të poenëve.

për të realizuar kërkesat e arsyeshme të anëtarësisë e duke i dhënë përparësi dialogut.



Drejtorja Flocken është deklaruar se ETUCE mbështet fuqishëm angazhimet e SBASHK-ut dhe se duke dëshmuar këtë mbështetje do të nis në emër të Unionit të Sindikatave të Arsimit të Evropës letrë kryeministrit Hoti dhe Ministrit Likaj për t' u treguar për mbështetjen ndaj SBASHK-ut.

Ashtu si kishte premtuar edhe kishte vepruar drejtorja e përgjithshme e ETUCE dhe kishte nisur letrë në adresën e Kryeministrit Hoti dhe të Ministrit Likaj duke dëshmuar edhe një herë për përkrahjen dhe solidaritetin me SBASHK-un të Komitetit të Sindikatave të Arsimit të Evropës, që përfaqëson 127 sindikata arsimore me 11 milionë anëtarë. ETUCE përmes këtyre shkresave ka kërkuar angazhim dhe dialog të institucioneve qendrore me SBASHK-un për të gjetur zgjidhje të pranueshme për të dy kërkesat legjitime të anëtarësisë.



Education International
Internationale de l'Éducation
Internacional de la Educación

<http://www.ei-ie.org>

EUROPEAN REGION-
ETUCE

President
Larry FLANAGAN

Vice-Presidents
Odile CORDELLIER
Andreas KELLER
Trudy KERPERIEN
Dorte LANGE
Galina MERKULOVA
Branimir STRUKELJ



Boulevard Bischoffsheim, 15
1000 Brussels, Belgium
Tel +32 2 224 06 91/92
Fax +32 2 224 06 94
secretariat@csee-etuce.org
<http://www.csee-etuce.org>

European Director
Susan FLOCKEN

Treasurer
Joan DÓNEGAN

ETUCE

European Trade Union Committee for Education
EI European Region

To: Mr. Avdullah Hoti
Prime Minister of Kosovo¹
E-mail: zko.zkm@rks-gov.net

Mr. Ramë Likaj
Minister of Education and Science of Kosovo
E-mail: rame.likaj@rks-gov.net

Brussels, 18 January 2021
Ref.: SF/vd/10176

Subject: Solidarity with the Union of Education, Science and Culture of Kosovo (SBASHK)

Dear Minister,

Dear Prime Minister,

The European Trade Union Committee for Education (ETUCE) represents 127 education trade unions i.e., more than 11 million teachers and other education personnel in Europe. As a recognised Social Partner in education at EU level, ETUCE meets at regular intervals with the European Federation of Education Employers (EFEE) in the frame of the European Sectoral Social Dialogue Committee for Education to negotiate and discuss education and employment topics relevant to teachers, academics, and other education personnel. ETUCE is a European Trade Union Federation within ETUC, the European Trade Union Confederation. ETUCE is also the European Region of Education International (EI), the global federation of education trade unions.

With this letter ETUCE expresses solidarity with its member organisation in Kosovo, the Union of Education, Science and Culture of Kosovo (SBASHK), and firmly supports its fair demands that have been tabled before you.

Together with SBASHK we ask you to sign without further delay the final version of the new Collective Agreement the text of which was agreed by the Joint Commission and support its demand for an additional monthly payment for teachers and other education personnel of 100,00 Euros in recognition for the extraordinary efforts in continuous quality education during

¹ *This designation is without prejudice to positions on status and is in line with UNSCR 1244/1999 and the ICJ Opinion on the Kosovo declaration of independence.

the pandemic and compensation for the exposure to the risk of COVID-19 in their work along the compensation paid to workers of other essential sectors.

We continuously stress that education plays a crucial role in addressing and recovering from the already existing and future tremendous negative consequences of the COVID-19 pandemic on society as a whole. Whilst being on the front line, teachers and other education personnel require greatest support from government officials which is impossible without consulting education trade unions. In the ongoing circumstances, it is more important than ever to commit and further contribute to effective social dialogue and collective bargaining. Meaningful social dialogue and collective bargaining must remain central.

We call on the Kosovar authorities first and foremost to meet its commitments and sign the text of the already agreed draft Collective Agreement as well as to seriously consider the additional monthly allocation for teachers and other education personnel in recognition of their tremendous work in upholding quality education in these extraordinary times.

ETUCE continues monitoring the situation.

Yours Sincerely,

Susan Flocken
European Director


Një aktivitet me arritje të larta e që po vazhdon edhe në vitin 2021


Kërkesa të shumta për trajnimet e licencuara të SBASHK-ut

Krahas shumë angazhimeve në vitin 2020, SBASHK-u ka shënuar arritje të larta edhe në organizimin trajnimeve të licencuara për anëtarët e vetë nga e tërë Kosova. Kërkesa të shumta të anëtarësisë përmes kryetarëve të nivelit komunal sindikal kanë vazhduar të vijnë në SBASHK edhe në janarin e vitit 2021 dhe prandaj koordinatori për organizim të brendshëm, Ymer Ymeri, zyrtarja për trajnime Albina Arifi dhe i tërë stafi kanë vazhduar me përkushtimin me qëllim që ky aktivitet të vazhdojë me rrjedhë të mbarë.


Kështu në vikendin e 9 janarit u nis me dy grupe të trajnimit, për të vazhduar në ditët në vijim edhe me grupe të tjera të trajnimeve bazuar në kërkesat dhe vullnetin e anëtarësisë. Më 9 janar u fillua me trajnimet "Udhëheqja dhe planifikimi strategjik në Arsimin Parauniversitar", me trajnerin prof. dr. Hysen Sogojeva dhe me trajnimin "Mësimdhënia e gjuhës shqipe dhe letërsisë në ciklin fillor e të mesëm" me trajneren Mjellma Zhara, e cila u ndihmua kohë pas kohe nga trajneri prof. dr. Atdhe Hykolli.

Sikur herëve tjera, në nisje të këtij aktiviteti, kryetari i SBASHK-ut Rahman Jasharaj dhe koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri janë kyçur për të bashkëbiseduar me pjesëmarrësit dhe me trajnerët. Pjesë e kësaj bashkëbisede ishin edhe kryetari i nivelit komunal sindikal për Malishevën Skënder Gashi dhe anëtarja e stafit qendror Afërdita Mirena.






Kryetari i SBASHK-ut Rahman Jasharaj ka përgëzuar pjesëmarrësit dhe gjithë kolegët kudo në Kosovë për angazhimet dhe përkushtimin dhe angazhimet në realizimin e misionit të shenjtë të tyre për edukimin e arsimimin e brezave në këto kushte tepër të vështirësuar nga Covid 19 duke u shprehur i sigurt se kolegët tanë kudo në Kosovë janë përgatitur edhe për fillimin e mbarë të periudhës së dytë të procesit mësimor me besimin e plotë se institucionet do të angazhohen sinqerisht në përmbushjen e kërkesave legjitime të të punësuarve në sistemin arsimor, e që janë bërë publike nga SBASHK. Ai ka falënderuar për angazhimin edhe trajnerët dhe koordinatoren për organizim të brendshëm dhe tërë stafin qendror, kurse koordinatori Ymer Ymeri ka kujtuar pjesëmarrësit për rregullat që duhet respektuar me qëllim që trajnimet të kenë rrjedhë të mbarë.



Kryetari i Kuvendit të Sindikatës së Arsimit Parauniversitar për Malishevën, Skënder Gashi duke marrë pjesë në bashkëbisedë me pjesëmarrësit ka vlerësuar lart angazhimet dhe arritjet e stafit qendror të SBASHK-ut në shërbim të anëtarësisë duke përmendur edhe organizimin e suksesshëm të trajnimeve, si një aktivitet tepër të rëndësishëm.

Duke vazhduar me organizimin e këtij aktiviteti në muajin janar 2021 e bazuar në vullnetin e kolegëve tanë nga e tërë Kosova koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri bashkë me stafin qendror

kanë arritur të bëjnë përgatitjet e duhur për të nisur me grupe të reja të trajnimeve "Forcimi i kapaciteteve për udhëheqjen efektive të dialogut social" "Udhëheqja dhe planifikimi strategjik në Arsimin Parauniversitar", "Edukimi medial dhe roli i tij në zhvillimin shoqëror dhe demokratik", "Mësimdhënia e gjuhës dhe letërsisë shqipe për ciklin fillor dhe të mesëm".



Në grupin e trajnimit "Udhëheqja dhe planifikimi strategjik në Arsimin Parauniversitar" ishte angazhuar trajneri Burim Avdiaj, por ka qenë i pranishëm vazhdimisht edhe trajneri i ri Rasim Zariqi për të fituar përvojë që në të ardhmen të jetë në krye të kësaj detyre. Bazuar në kërkesën e anëtarësisë kishin nisur me këtë aktivitet edhe dy grupe në trajnimin "Forcimi i kapaciteteve për udhëheqjen efektive të dialogut social" me trajnerët Safet Beqiri dhe Skënder Gashi, pastaj trajnimi "Mësimdhënia e gjuhës dhe letërsisë shqipe për ciklin fillor dhe të mesëm" me trajnerin Hajrip Koçinaj. Trajnim tjetër i organizuar me sukses ishte edhe "Edukimi medial dhe roli i tij në zhvillimin shoqëror dhe demokratik" me trajnerët Sami Shala, Hysen Hyseni dhe Gëzim Qerimi.

Edhe në fillimet e kësaj aktiviteti ishin kyçur kryetari Rahman Jasharaj dhe koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri për të bashkëbiseduar me pjesëmarrësit dhe me trajnerët.

“Ju përgëzoj juve dhe gjithë kolegët tanë kudo në Kosovë për përkushtimin në misionin e arsimit dhe edukimit të brezave edhe për kundër kushteve tepër të rënduara në pandemia dhe për vullnetin e shprehur për pjesëmarrje në këtë aktivitet të rëndësishëm, që krijon mundësi të marrjes së njohurive të reja dhe të bashkëbisedës për të këmbyer përvoja për temat kyçe që shtjellohen në këto trajnime”, është shprehur kryetari Jasharaj duke vlerësuar lart edhe angazhimin trajnerëve dhe të koordinorit për organizim të brendshëm Ymer Ymeri dhe tërë stafin qendror.

Doli nga shtypi gazeta vjetore “Rrugëtimi i SBASHK-ut 2020”

Kujtesë e shkuar për ngjarjet, sfidat, shqetësimet dhe arritjet



Me qëllim që të bëhen pjesë e kujtesës dhe që lexuesit t'i ketë në të njëjtin vend shkrimet për ngjarjet, sfidat, shqetësimet dhe arritjet kyçe të SBASHK-ut, u punua për një kohë të gjatë dhe u vazhdua tradita e botimit të gazetës vjetore me emrin simbolik “Rrugëtimi i SBASHK-ut”. Kjo gazetë u përgatit me përkushtim dhe krahas shkrimeve ka edhe mjaft foto të zgjedhura që ilustrojnë e faktojnë ngjarjet e aktivitetet e shumta

të SBASHK në shërbim të anëtarësisë, që kanë ndodhur gjatë gjithë vitit 2020.

Gazeta është punuar duke respektuar kronologjinë e ngjarjeve dhe rrugëtimin nëpër ditë, javë e muaj të 2020. Shkrimet në këtë gazetë javore janë grupuar sipas përmbajtjes dhe natyrës së aktiviteteve. Kështu vend meritore kanë zënë angazhimet, ngjarjet, vendimet dhe aktivitetet e SBASHK në shërbim të anëtarësisë për të mos harruar Manifestimin kushtuar ditës së madhe të mësuesit e shkollës shqipe, kontributit të lartë për rrjedhën e mbarë të mësimi nga larg, realizimit të kresave të anëtarësisë, traditës së mirë për pushimet në bregdetin shqiptar të një numri të konsiderueshëm të kolegëve tanë nga tërë Kosova, mbajtjes me sukses të dhjetëra e dhjetëra trajnimeve. Kjo gazetë shpalos kujtesën edhe për ngjarje të tjera, për takime të shumta me institucionet, por edhe për komunikimin e bashkëpunimin me Komitetin e Sindikatave të Arsimit të Evropës dhe me Internacionalen Botërore të Arsimit.

Nuk po tregojmë më shumë për “Rrugëtimi i SBASHK-ut 2020” sepse kryetarët e nivelit komunal sindikal dhe të Universiteteve janë duke marrë ekzemplarë për secilin institucion arsimor dhe prandaj kolegët tanë sindikalistë se shpejti do ta kenë mundësinë ta lexojnë gazetën e tyre vjetore.